

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, Znj. Mirela Muça, mbi

Programit të Ri të Statisikave Zyrtare 2017-2021

Tiranë, 20 Prill 2016: Instituti i Statistikave ka filluar një proces i cili është mjaft rëndësishëm dhe kompleks nga natyra e tij, hartimin e Programit të Ri të Statisikave Zyrtare 2017-2021.

Programi pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare (PSZ) është dokumenti bazë që parashikon prodhimin nga Sistemimi Kombëtar Statistikor të të dhënave statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar garancinë e zbatimit të parimeve statistikore të parashikuara në ligj si dhe në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane. Programi përmban të gjithë indikatorët që duhet të prodhohen nga këto agjenci statistikore në këto 5 vitet e ardhshme, ndaj dhe ky takim do të shërbeje si pikënisje e këtij procesi konsultues.

Pra, në zbatim të kuadrit ligjor për statistikat, përcaktohet INSTAT si prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë dhe institucioni përgjegjës për koordinimin e funksionimin e Sistemit Kombëtar Statistikor.

Veprimtaria koordinuese përfshin, bashkëpunimin me agjencitë statistikore për projektimin dhe zbatimin e programit; sigurimin e uniformitetit të metodologjisë së përdorur gjatë kryerjes së vrojtimeve statistikore; sigurimin e mbështetjes teknike në mënyrë që veprimtaria statistikore të përputhet me standardet ndërkombëtare; kontrollimin e zbatimit të cilësisë statistikore, sipas parimeve të përcaktuara në nenin 4/1 të ligjit për statistikat; pjesëmarrjen në proceset e krijimit të sistemeve kombëtare statistikore të informatizimit; përfaqësimin e Sistemit Kombëtar Statistikor në sistemin statistikor evropian dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe ndërtimin dhe mbajtjen e rrjetit profesional me institutet kombëtare të statistikave të vendeve të tjera; të sigurojë se statistikat në program janë zhvilluar, prodhuar dhe shpërndarë sipas parimeve të parashikuara në këtë ligj, etj

Sistemi Kombëtar Statistikor në vendin tonë përbëhet nga një numër institucionesh dhe organizatash që veprojnë në territorin e saj, të cilët grumbullojnë, përpunojnë dhe shpërndajnë statistika zyrtare sipas Programit të statistikave zyrtare.

Në Sistemin Kombëtar Statistikor bëjnë pjesë INSTAT, agjencitë statistikore dhe Institucione publike ose private, të cilat disponojnë baza të dhënash, përpunojnë të dhëna për politikat e institucionit apo të tretëve ose publikojnë të dhëna statistikore, por që nuk janë zyrtare.

“Agjenci statistikore” sipas programit aktual si autoritete të autorizuar, përveç INSTAT, janë Ministria e Financave (me 9 aktivitete statistikore) dhe Banka e Shqipërisë (me 65 aktivitete statistikore). Këto agjenci statistikore si dhe institucionet qendrore e vendore duhet t’i sigurojnë INSTAT-it të gjitha dokumentet dhe të dhënat e nevojshme që ata grumbullojnë ose administrojnë, për ta lejuar atë të përmbushë detyrimet e parashikuara në ligj dhe Programin e Statistikave Zyrtare.

Procesi i përgatitjes së PSZ është kompleks dhe gjithëpërfshirës. Ai kërkon angazhimin e Institutit të Statistikave si prodhuesin dhe shpërndarësin kryesor të statistikave zyrtare por njëkohësisht edhe të agjencive statistikore, ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera publike të cilët janë përgjegjës për grumbullimin, prodhimin dhe administrimin e burimeve administrative sipas fushave të tyre të kompetencës si dhe të shoëqërisë, botës akademike dhe publikut të gjerë.

Për hartimin e këtij programi janë ngritur grupe teknike pune, të posaçëm për secilën fushë statistikore. Këto grupe teknike pune përbëhen nga ekspertë të INSTAT dhe ekspertë/përfaqësues të ministrive dhe institucioneve shtetërore sipas fushës së tyre të kompetencës me qëllim përfshirjen e kontributit/ekspertizës së tyre dhe reflektimin e prioritetëve të këtyre institucioneve në këtë dokument të rëndësishëm për prodhimin e statistikave për 5 vitet e ardhshme. Është e domosdoshme që përfaqësuesit e institucioneve të jenë aktivë në mbledhjet e grupit të punës si dhe të garantojnë komunikimin midis INSTAT dhe institucioneve të tyre për çeshtjet që lidhen me hartimin e PSZ.

Ky program do të ketë edhe një përfaqje strategjike për projekte që kanë të bëjnë me modernizimin dhe transformimin e prodhimit të statistikave, mënyra më efçente të mbledhjes dhe validimit të të dhënave, përdorimin më të gjerë të të dhënave administrative/regjistrave ekzistues, zhvillimin e instrumentave të përbashkët të sistemit statistikor si dhe një shpërndarje më efçente të të dhënave, etj.

Statistikat zyrtare janë matësi me të cilin Bashkimi Evropian monitoron progresin e vendin tonë me qëllim integrimin në familjen e madhe të BE-së ndaj dhe është detyrimi i të gjithë ne ta cojmë këtë proces përpara sipas standardeve të kërkuara.